

Zjarret, disa masa praktike mbrojtese qe duhet te dime.

Per shkak te pranise se lendeve djegese ne ambjentete e shtepise, gaz, lende te tjera qe potencialisht mund te shkatojne zjarre, shkrepse, cakmake, energjia elektrike etj eshte gjithnje e pranishme mundesia per te patur situat te pakendeshme aksidentesh dhe lendime te jetes se njerezve.

Statistikast flasin per afro 500 zjarre ne vit qe shkaktohen ne ambjentet e shtepise nga pakujdesite qe tregohen.

Disa keshilla praktike eshte e mundur te transmetohen tek publiku, nje lloj informacioni dhe kulture qe sherbejne ne jeten e perditeshme ne qellim te parandalimit te zjarreve ne ambjentet e shtepise, pra shmangies se aksidenteve te cilat nuk jane te pakta ne kete lloj.

A mund ti parandalojme zjarret, kush jane disa masa praktike mbrojtese qe duhet te dime?

Se pari kujdesi duhet treguar qe ne konstruksionin e shtepise, qe ne projekt , ndertimin e paisjen e saj me orendite e nevojshem te perdorimit te perditeshem.

Instalimet elektrike dhe ato te gazit duhet te behen nga specialiste te fushes. Kerko prej tyre te vendosin automate elektrike dhe detektore te gazit te cilat luajne rolin e ‘‘rojës’’ne shtepi.

Aty ku ekzistojne paisjet e fikjes se zjarrit beni perpjekje ti njihni dhe te dini si perdoren, ne te kundert kujdesuni qe keto paisje te vendosen sa me pare.

Per ata qe perdorin duhan te tregohen te kujdesshem , mos pijne cigare ne shtrat, te shuajne mire bishtat e mbetura. Kjo te behet gjithnje kur shtrihemi per te fjetur dhe kur largohemi nga shtepia.

Dyert e dhomave te mbahen te hapura qe te orjentoheми ne rast rreziku.

Fikini me kujdes dhe hiqini nga priza te gjitha paisjet elektrike, mbyll rubinetat e gazit kur bie per te fjetur ose largohesh nga shtepia.

Kujdesu qe te kete ndricim te mjaftueshme ne ambjete, koridor, banje apo shkallet e pallatit.

Shenoni numerat e telefonave per sherbime urgjence ne vende te dukeshme qe te beni ne kohe thirrjen tuaj.

Çfare duhet te bejme kur konstatojme vatra zjarri ne ambjentet ku jetojme?

Reago menjehere ne raste kur ndjen ere te rende, tymi, gazi, shkendia elektrike.etj.

Lajmero te gjithë pjestaret e familjes, mbyllni valvulat e gazit, ulni automatin kryesore për të ndërprerë energjinë elektrike, hapini të gjitha dyert e dritaret pasi kështu ndihmoni në ajrimin e ambjenteve, asnjëherë mos celesat e dritave, mos ndizni shkrepse ose cakmake se mund të provokojnë shperthime, tregohuni i qetë se veproni me kujdes dhe pa panik.

Për fikjen e zjarreve përdoren mjetet e keshilluashme, flaket e shkaktuara nga vajrat ndalen duke vendosur kapakun mbi to. Menjëherë duhet fikur soba.

Kujdes mos përdorni ujë në keto raste se mund ta komplikoni me shumë situatën dhe të merrni lëndime të padëshiruara. Rastet kur nuk duhet përdorur ujë janë edhe ato të shkaktuara në rrjetin elektrik.

Uji përdoret në mase kur zjarri përfshin orëndite të tjera me presion dhe nga rubinetat. Por nëse nuk dispononi mjete për të shuar zjarrin dhe flaket janë përhapur largohuni menjëherë nga keto ambjente dhe ndihmoni të tjerët, fëmijë, pleq apo të pamundur të largohen nga vendi i rrezikut.

Mos u kthe në vendin ku ka shperthyer flaka.

Njofto fqinjin apo shërbimet e specializuara për shuarjen e zjarreve.

Si veprohet gjatë daljes nga vendi i shperthimit të zjarrit?

Duke vepruar të qetë dhe me shpejtesi shpëtojmë veten dhe të tjerët nga lëndimet.

Më të konstatuar zjarrin, duhet të njoftojmë anëtarët e tjerë të familjes ose të ambjenteve ku banojmë, hotel etj, duke i zgjuar nga gjumi dhe ndihmuar me sa të keni mundësi.

Gjatë largimit mos mbyllni dyert dhe dritaret, vendet nga ku është mundësia për të larguar në rast rreziku. Veprime të nxituara pengojnë edhe nderhyrjen e specialistëve të emergjencës civile.

Nuk duhet përdorur ashensori, gjatë zbritjes, shkallet janë më të sigurt, zbrisni me kujdes, pa rremujë, mos shtyni të tjerët, fëmijë pleq e të pamundur, ndihmoni ata.

Jo vetëm gjatë qëndrimit por edhe në levizje qëndro i kurrusur sepse eliminon në mase të madhe mundësinë e thithjes së gazrave toksike të cilat janë më të shpeshta në lartësi.

Mbulo gojë dhe hundë me shami ose gjera të tjera të castit se ndihmon të marrësh frymë lehtësisht.

Në duhet të mesojmë të veprojmë edhe në kushtet ekstreme të bllokimit në ndërtesë.

Përpiqu të njoftosh fqinjet, zjarrfikësit me telefon, duke u dhënë atyre vendin se ku ndodhëni.

Ne perpjekje per tu larguar kontrollo dyet e mbyllura mos jane te nxehta ne pjesen e jashtme. Ne raste kur ajo eshte e nxehte kerko dalje tjeter, ne pamundesit sinjalizo me c'te mundesh ne dritare qe te dallohesh nga ata qe te afrojne ndihme.

Ne dendesi te larte tymi e zjarri shtriu, leviz me zvarritje ne drejtime qe te ndihmojne per te dale. Kur konstaton flake ne teshat e tua mos vrapo, rrotullohu ne dysHEME ashtu sic je i shtrire se kjo te ndihmon te fikesh vatrat.

Po keshtu edhe me persona qe jane perfshire nga flaket, mbeshtilli me carcafe, apo rroba te tjera sepse kjo i shpeton nga djegia serioze apo dhe vdekja.
Mund te jete e nevojshme te afroni ndihmen e pare, ndaj duhet te dish te veprosh me shpejtesi dhe profesionalizem.

Hidh uje te paster te fresket mbi vendet e djegura. Lereni sipas mundesive qe uji te rrjedhe nga 5 deri ne 10 minuta.

Mos ngacmoni fluskat ne lekure duke i shpuar ato. Ne rast se teshat jane ngjitur ne trup, lekure, hiqini me kujdes, jo shpejt se mund te shkaktoni lendime te renda. Kur konstaton plage serioze njoftoni sherbimin mjekesore te specializuar.

Ndihmoni te lendarit te marrin lengjet e mjaftueshme, uje, lengje frutash, caj etj.
Ne cdo rast mos harroni te njoftoni sherbimin zjarrfikes ne numerin pa pagese
Tel 112